



ADMINISTRATA KALIMTARE E DEPARTAMENTIT TË ARSIMIT, SHKENCËS DHE I TEKNOLOGJISË

UDHËZIM ADMINISTRATIV

LËNDA: Kontrata e punësimit për Zyrtar të Arsimit

NUMËR: DES (1) 4/2002

DATA: 28 janar 2002

Në përputhje me Rregullorën e UNMIK-ut Nr.2000/11 të 3 marsit 2000 mbi themelimin e Administratës së Departamentit të Arsimit dhe Shkencës dhe Administratës Kalimtare e Departamentit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (këtu e tutje si AKDASHT) lëshon Udhëzimin Administrativ sin ë vijim:

Pjesa 1

Përcaktimi

1. Për qëllimet e këtij Udhëzimi Administrativ do të vlejnjë këto definicione si në vijim:

“Zyrta Arsimi” është secili punëtor i AKDASHT-it i cili është caktuar ose si Zyrtar Arsimit ose një Zyrtar i Lartë Arsimit nga AKDASHT-i.

“Kontrata e punësimit” është kontratë e cila është mes AKDASHT-it dhe cilitdo Zyrtar Arsimit apo Zyrtar i Lartë Arsimit gjatë vitit kalendarik 2001

Pjesa 2

Kontrat ekzistuese të punësimit të cilave i skadon afati

2. Të gjitha kontratat ekzistuese të punësimit mes AKDASHT-it dhe Zyrtarëve të Arsimit dhe Zyrtarëve të Lartë të Arsimit të tij i ka skaduar ditën e Hënë 31 dhjetor 2001.

Pjesa 3

Vazhdimi i Kontratave të Punësimit

3. (a) Me këtë Udhëzim Administrativ të AKDASHT- it me këtë vazhdon kontratat e punësimit të gjithë Zyrtarëve të Lartë të Arsimit.
1. (b) Kontratat e vazhduara duhet të hynë në fuqi prej 1 janar 2002 deri në fund 31 dhejtor 2002.
3. (c) Nga Zyrtarët e Arsimit dhe Zyrtarët e Lartë të Arsimit nuk kërkohet që të nënshkruajn një kontratë të re apo ndonjë document tjetër në mënyrë që të kualifikohen për vazhdim të kontratave të tyre të punësimit. Kontratat e punësimit janë të vazhduara me një akt të këtij Udhëzimi Administrativ.

Pjesa 4

Përjashtimet

4. Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi vetëm atëher për vazhdimin e kontratave të punësimit të cilave i ka skaduar afati me 31 dhjetor 2001. Nuk vazhdohet asnjë kontratë e punësimit të së cilës i ka skaduar afati apo përfunduar përshkak se Zyrtari i Arsimit apo Zyrtari i Lartë i Arsimit është:
 - (a) Ka arritur moshën e pensionit të detyrueshëm;
 - (b) Larguar përshkak të përmbushjeve të detyrave në mënyrë të pakënaqëshme; apo
 - (c) Ka përfunduar kontratën e tyre për ndonjë arsye tjetër sesa kalimin e kohës.

Pjesa 5

Kushtet

5. Kushtet për vazhdimin e kontratës së punësimit janë identike me ato të cilat janë lëshuar në kontratat origjinale të punës. Kontratat e vazhduara të punësimit nuk janë ndryshuar apo përmirësuar në asnjë mënyrë, përveç datës së skadimit të tyre.

Pjesa 6

Hyrja në fuqi

6. Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi me 1 janar 2002

Prof. Dr. Michael Daxner
Zyrtar Kryesor Ndërkombëtar
Departamenti Kalimtar i Arsimit, Shkencës dhe i Teknologjisë